



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:041057

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05847452

C.nr.353/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit B.R. nga fshati N., Komuna e P., të cilin e përfaqëson i autorizuari, Blerim Ademaj, avokat në Pejë, kundër të paditurit H.K., nga P., të cilin e përfaqëson e autorizuar Hamijeta Myftari, avokate në Pejë, për shkak borxhit, vlera e kontestit 12.000€, me dt.18.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesë padia e paditësit B.R. nga fshati N., Komuna e P., ashtu që:

DETYROHET i padituri H.K., nga P., që paditësit B.R. nga fshati N., Komuna e P., t'ia paguaj borxhin në shumë prej 12.000€, më kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e vendim marrjes me dt.18.06.2024, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumën 1.119€ e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m

*Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me padi gjatë shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 12.000€, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, me arsyetim se me dt.09.09.2019, paditësi B. me të paditurin H., kishin lidhur marrëveshje për huan, ashtu që paditësi i'a ka huazuar të paditurit shumën prej 12.000€, për nevojat e tij personale pa kamat, pa interes dhe në mënyrë miqësore, me kusht që ato para t'i kthehen huadhënësit më së largu deri më dt.09.10.2019, se për këtë kanë përpiluar edhe marrëveshjen me shkrim. Ka theksuar se prej asaj kohe gjerë më sot akoma nuk i'a ka kthyer borxhin, edhe pse gjithnjë ka premtuar.*

Ka propozuar që të pas administrimit të provave, të aprovet kërkesëpadia në tërësi si e bazuar.

*Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë thënieve nga padia dhe kërkesa e saj, duke i kundërshtuar pretendimet e palës së paditur...*

*Në fjalën përfundimtare ka potencuar se gjatë këtij shqyrtimit është vërtetuar se i padituri H., paditësit B. i'a kishte marr hua shumën prej 12.000€, mirëpo këtë shumë nuk e ka kthyer gjer më tani.*

Këto pretendime janë vërtetuar edhe me dëshminë e paditësit B., në cilësinë e dëshmitarit, i cili ka argumentuar shumë çartë, se si e kishin përpiluar dhe nënshkruar një marrëveshje në mes veti, ka ritheksuar se i padituri gjithnjë premtonte se shumën e dhënë hua, do ta paguaj, mirëpo deri me tani nuk e ka përmbaruar.

Këto pretendime të paditësit i ka pohuar edhe e aut. e të paditurit H., në përgjigje në padi të dt.19.09.2023. Gjykatës i ka propozuar që kërkesë padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të detyroj të paditurin që shumën prej 12.000€, t'ia kthejë paditësit me kamatë ligjore prej 8% , që nga dt.09.10.2019.

*Shpenzimet procedurale* i ka kërkuar dhe atë: për përpilimin të padisë shumën prej 208€, për mbajtjen e 3 seancave nga 270.40€ e në shumë prej 811.20€, dhe për taksë gjyqësore shumën prej 100€ e në shumë të tërësishme prej 1.119.20€.

*I padituri, përmes të autorizuarës së tij në përgjigje në padi, të bërë me shkrim me dt.19.09.2024, ka deklaruar se ai me paditësin, me dt.09.09.2019, kanë bërë një marrëveshje jo formale, për huazim të një shume të hollash prej 12.000€, me obligim të kthimit prej një muaji, ku mbasi ishin shokë, nuk kanë pas një marrëveshje formale, por edhe mos respektimi i afatit nuk ka qen problem, pasi që as paditësi për këtë shkak nuk e ka kërkuar kthimin e borxhit, e as pala e paditur nuk i ka jap shumë rëndësi kësaj pune.*

Ka potencuar se paditësi ka pasur edhe obligime të tjera ndaj të paditurit H., ku para dy viteve e ka blerë banesën nga i paditurin shumë të volitshme prej 51.000€, e të cilën shumë e ka paguar paditësi sipas para kontratës së vërtetuar nga ana e noterit Shpend Haskaj. Ka cekur se banesa dhe parkingu kanë vlerën më të madhe se sa është cekur në para kontratë dhe vlera e tyre është dukshëm më e madhe, por duke marr parasysh miqësinë, mes veti paditësi nuk e ka shikuar për me kompenzu tek paditësi për këtë.

Ka cekur se sip. e banesës së blerë, ma qenë për 8m<sup>2</sup> më e madhe, duke e llogaritur një metër katror me çmimin e vitit 2017-që ka qenë 1.000€ për m<sup>2</sup>, ashtu që shuma e tejkalon shumën e cekur të para kontratës për 8.000€. Se edhe auto parkingu-depo i shitur në sip. prej 18m<sup>2</sup> i cekur në kontratë, e tejkalon sip. për 10m<sup>2</sup>, se tejkalimi i sipërfaqes ka ndodhur si mundësi nga miku, se për këtë i padituri nuk ka dashtë të ushtroj kundërpadi, por ka propozuar që të arrihet një marrëveshje dhe të bëhet zgjidhje e kënaqshme për të dyja palët. Ka propozuar ta hudh poshtë si të pa pabazuar kërkesë padinë e paditësit si jo reale, pasi që në çmimin e banesës nuk kanë hyrë sipërfaqet reale...

*Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se borxhi ishte në shumë prej 10.000€ e jo në shumë prej 12.000€ siq është cekur në marrëveshje, pasi që janë pajtuar që 2.000€ t'ia japë më vonë e që realitet nuk ka ndodhur, ka ritheksuar që kanë qenë shokë të mirë, se 8m<sup>2</sup> janë më shumë e që kanë kushtuar 8.000€ + parkingu dhe këto janë llogaritur me shpresë që do të barazohen. Gjatë shqyrtimit ka hequr dorë nga dëgjimi i të paditurit H. duke u pajtuar që të dëgjohet vetëm paditësi në cilësi të dëshmitarit...*

*E autorizuar e të paditurit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar, se duke marr parasysh dëshmitë të paraqitura deri me tani si edhe deklaratën e paditësit të dhënë në procesverbalin e dt.22.04.2024, dhe pohimit të palës paditur që borxhi ka ekzistuar në mes të dy palëve, pasi që kanë qenë shok të ngushtë, dhe hala e kanë këtë miqësi, huan paditësi nuk e ka kërkuar që t'ia kthej, por kanë qenë fjalët që borxhi të zëvendësohet me një dyqan, ashtu që të paguhet nga ana e paditësit vetëm diferenca, por këtë marrëveshje nuk e kanë arritur.*

Ka cekur se dy vite me parë, ata kanë lidhur një kontratë mbi blerjen e një banese me dt.04.04.2017, e cila ka përfshire 89m<sup>2</sup>, dhe një auto parking- depo prej 18m<sup>2</sup> për shumën prej 51.000€, këtë shumë paditësi e ka paguar sipas kontratës të vërtetuar nga ana e Noterit-Shpend Haskaj, por banesa dhe auto parking kanë qenë në sip. më të madhe se sa ajo në kontratë, dhe vlera e tyre është dukshëm më e madhe, e realisht më e madhe për 8m<sup>2</sup>, duke llogaritur 1m<sup>2</sup> me çmimin e vitit 2017, që ka qenë 1000€ për 1m<sup>2</sup>, ashtu që shuma e banesës në realitet është për 8.000€, më e shtrenjte, kurse depoja tejkalon sipërfaqen prej 10m<sup>2</sup>, pra ka 28m<sup>2</sup>, në vend 18m<sup>2</sup>, të cekur në para kontratë e shuma e tejkalar është prej 4500€, mbasi që është vlera e m<sup>2</sup> në depo 450€ për m<sup>2</sup>. Pra tejkalimi i shumës kur të mblidhet është gjithsejtë 12.500€.

Ka cekur se i padituri nuk ka dashur të ushtroj kundër padi, por i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh të cekurat më lart dhe borxhin i cili ekziston në mes ndërëgjyqësve. Andaj i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të hudhet si e pa bazuar, pasi që borxhi i kërkuar nuk

është real, dhe se sipërfaqja e banesës dhe depos është më e madhe se ajo në para kontratë. Shpenzimet i ka kërkuar: për përgjigje në padi shumën prej 208€, për tri seanca te mbajtura nga 270.40€ e në shumë prej 811.20€ e gjithsejtë është 1.019.20€.

*Gjykata në këtë çështje kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka zhvilluar procedurën ku si provë administroi: marrëveshjen e lidhur në mes të ndërgjyqësve në origjinalë për huan, të lidhur me dt.09.10.2019; Para kontratën e shitblerjes së banesës, të dt.04.04.2017, dëshminë paditësit, deklarinimet e të autorizuarve të ndërgjyqësve dhe të gjitha shkresat e tjera që gjenden në lëndë.*

*Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke vërtetuar këtë gjendje faktike:*

*-se paditësi B.R. nga fshati N., Komuna e P., dhe i padituri H.K., nga Peja, kanë lidhur marrëveshje për huan, jo formale me dt.09.10.2019.*

*Paditësi B. i'a ka huazuar të paditurit H., shumën prej 12.000€ në shfrytëzim, për nevojat e tij personale, pa kamat, pa interes. Këtë marrëveshje e kanë lidhur për shkak të miqësisë që e kanë pas në mes vete ndërgjyqësit.*

*Marrëveshjen e kanë përpiluar me shkrim dhe e njëjta e ka përmbajt tekstin si vijon:  
„, Unë B.R. ia huazoj H.K. me datë 09/09/2019 12000€ ( dymbëdhjetë mijë euro) për nevojat personale deri me dt.09/10/2019 në mënyrë miqësore.”, këtë marrëveshje e kanë nënshkruar këtu ndërgjyqësit ku i kanë dhënë edhe numrat personalë.*

*Gjykata ka gjetur se në mes të ndërgjyqësve, nuk është kontestuar marrëveshje e lartë cekur, dhe nuk është kontestuar as fakti se huamarrësi këtu i padituri H., prej momentit të marrjes hua të shumës prej 12.000€ e gjerë më tani, nuk e ka kthyer asnjëherë këtë shumë, nuk është respektuar marrëveshja nga ana e tij, gjegjësisht nuk e ka respektuar afatin e cekur në këtë marrëveshje, të lidhur pa presion e në kërkesë të vetë të paditurit H..*

*Gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia e paditësit, është e bazuar, dhe se i padituri H., është i detyruar që në bazë të nenit 567 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD) me të cilin decidivisht është paraparë: „me kontratën e huas huadhënësi obligohet t'ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet t'ia kthej pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe cilësisë së njëjtë”.*

*Kështu që në momentin e lidhjes së marrëveshjes lëndore në mes të ndërgjyqësve, ka lindur edhe detyrimi për huamarrësin H.-këtu të paditurin, ashtu sikurse e kanë parashikuar vetë palët me vullnetin e tyre të lirë e pa presion pas hartimit me shkrim dhe nënshkrimin e saj...*

*Kjo gjykatë gjenë se edhe forma e përpilimit të marrëveshjes ka qenë e lirë, pasi që kontrata për huan, për nga forma është kontratë konsensuale... dhe se me ligj është përcaktuar qartë se objekt i kontratës për huan mundë të jenë paraja(si në rastin konkret) dhe sasia e caktuar e sendeve të tjera të zëvendësueshme...se edhe afati i caktuar për kthimin e huas ka mbështetje ligjore.*

*Gjykata përveç tjerash gjenë, se i padituri duhet të veproi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku detyrohet në kthimin e huas, pasi që ka kaluar afti i parashikuar në marrëveshje për kthimin e huas...*

*Gjykata gjatë vendosjes pati parasysh edhe dëshminë e paditësi B., në cilësinë e dëshmitarit, i cili ka dëshmuar se të paditurin H. e ka shokë, se rrinë bashkë edhe me vëllezërit e tij, të cilët merren me ndërtimtari, dhe e kanë firmën e tyre „Muratori”...*

Ka konfirmuar se me dt.09.09.2019, e ka thirr H. në një kafë, dhe e ka lutur për t'ja dhënë 12.000€ borxh për 1 muaj, se e kishte një hallë personal, për të marr armaturë i nevojitej si parapagim... se paditësi ka pranuar, duke e njohur si person të mirë, dhe kanë përpiluar bashkërisht me shkrim një shkresë, që është në shkresat e lëndës, dhe se nuk kanë shkuar askund, por vetëm e kanë nënshkruar të dy, se i ka besuar se ai do t'ia kthej parat, mirëpo, kur është afruar data, ai i ka thënë se është duke e punuar një „dugojë në, P.” në P., dhe çmimi ishte 200.000€, ka cekur se ai nuk kishte mundësi materiale, dhe i ka thënë vetëm t'ia kthej borxhin mjafton, por se i padituri vazhdimisht ka vepruar me të njëjtat fjalë, dhe se paditësi nuk kishte mundësi e as nevojë të marr ndonjë objekt si kompensim, ku duhej gjithsesi që të shtoj para të mëdha.

Ka cekur se e ka detyruar që të ushtroj këtë padi, dhe me të marr padinë atëherë ka dalë me fjalë tjera se banesën që e ka blerë nga ai, ku jeton kinse i'a paska lënë më të madhe, e kjo nuk është e vërtetë, se në realitet tek noteri është e shënuar me sipërfaqe pak më të madhe-89m<sup>2</sup>, e në realitet sipërfaqja sipas projektit ka qenë 88.5m<sup>2</sup>, këtë e ka thënë vet i padituri, mirëpo më ka thënë se po e rrumbullakojmë të jetë 89m<sup>2</sup>.

Ka dëshmuar se banesën që e ka blerë prej të paditurit dhe vëllezërve të tij, është blerë dhe paguar në vitin 2017, se ajo është çështje e mbyllur, se miqësia e tyre ka vazhduar, dhe prej miqësisë ai e ka marr guximin dhe e ka kërkuar borxhin, por borxhin e ka kërkuar në vitin 2019, dhe fare nuk ka qenë në pyetje sipërfaqja e banesës apo garazhdës së tij.

Ka dëshmuar edhe për garazhdën, se është fakt se e ka blerë në sip. prej 18m<sup>2</sup>, të kompletuar me derë, mirëpo garazhda nuk ka pasur derë, dhe aty afër ka qenë edhe një garazh tjetër me sipërfaqe prej 21m<sup>2</sup>, por pa derë, dhe paditësi i ka thënë se po e merr këtë garazh me këtë sipërfaqe, dhe pa derë, se derën do t'a vendosi vetë, në kompensim për sipërfaqe, dhe gojarisht ai e ka pranuar këtë, dhe kjo ka ndodhur pas blerjes së banesës, para se t'ia jap unë këtë borxh, kështu që as kjo nuk ka të bëjë me borxhin, sepse banesa dhe garazhda janë çështje tjetër.

Në veçanti ka cekur se atë ditë kur e kanë bërë atë shkresë-marrëveshjen për huan kanë qenë vetëm ndërgjyqësit e askush tjetër, se i kujtohet se i ka thënë se ky është borxhi familjar, dhe ky është obligim i gjithë vëllaznive, dhe nuk e din a janë të vërteta këto, dhe parat ja ka dhënë aty menjëherë, një pjesë e ka pasur me veti dhe një pjesë në bankë, se ja ka jap parat me mirëbesim, është me rëndësi që ai asnjë herë nuk i ka thënë se nuk e ka borxhin, dhe i ka ofruar mundësi siç e ka shpjeguar më lartë.

Ka dëshmuar se prej momentit kur e ka pasur për obligim me i'a kthyer të hollat, i'a ka kërkuar rregullisht, sepse ata rinin bashkë pinin kafe...ka sqaruar se as banesën as garazhden nuk e ka matur, sepse ju ka besuar atyre në fjalë, projekti ka qenë i përfunduar.

*Meqenëse i padituri*, me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar të kundërtën e borxhit të pretenduar nga pala paditëse, por përkundrazi e ka pranuar se i'a ka marr huan e cekur, atëherë gjykata e vënë para një situatë të tillë e duke u bazuar në këtë gjendje faktike, erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik-civil ndaj paditësit, për borxhin e papaguar në shumën prej 12.000€, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 567 të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve.

Këtë gjendje faktike gjykata e mbështeti duke u bazuar në provat që janë prezent në shkresa të lëndës, sikurse është marrëveshja e dt.09.09.2019, nga vërtetohet se i padituri i ka mbetur borxh shumën prej 12.000€ paditësit.

Pra, gjykata konstaton se i padituri nuk ka vepruar sipas marrëveshjes i cili fakt është jo kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse, në rastin konkret fakti notor është që i padituri nuk e ka kryer detyrimin ndaj paditësit për kthimin e huas në afat...

*Vendimin mbi shpenzimet procedurale*, gjykata e mori konform nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së, e sipas tarifës së OAK-ës, ashtu që i padituri është e obliguar që paditësit t'ia paguaj shumën e tërësishëm prej 1.119.20€, dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 208€, për taksë gjyqësore shumën prej 100€, për përfaqësim në tre(3) seanca të mbajtura (*nga 270€ për seancë*), dhe atë në shumë prej 811.20€, dhe shpërblimin për ekspertizën e ekspertit të makinerisë, në shumën prej 100€, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale është refuzuar si e pa bazuar.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.353/21 me dt.18.06.2024.

Gj y q t a r j a,  
Afërdita Mulhaxha,

**KËSHILLA JURIDIKE:**

*Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh,  
pas marrjes së aktgjykimit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë  
e përmes kësaj gjykate.*